



Uniti siamo forti!

Shtojcë për Kongresin e Unia prej 29 nëntori deri më 1 dhjetor 2012 në Cyrih.

Një etapë e re

Kongresi në Cyrih do të thotë një etapë e re për Unia. Në vitin 2004, me krijimin e Unia ne dhamë shenjën e startit. Pastaj e bëmë bashkimin dhe e forcua organizatën tonë. Kongresi i vitit 2008 në Lugano përcaktoi qëllime të rëndësishme strategjike: kthesa në drejtim të rritjes së anëtarësisë dhe për forcimin e njerëzve të besueshëm.

Bilanci i etapës së dytë ishte kryesisht pozitiv. Numri i anëtarëve të Unia së pari u stabilizua dhe tani ka tendencë rritjeje. Bazat për forcimin e anëtarëve tanë aktivë janë vënë. Kongresi në Cyrih tani ka shtruar këtë çështje: si mund të forcohet Unia edhe më shumë? Ne e propozojmë një strategji në thellësi: Unia dhe njerëzit e saj të besueshëm duhet të shtrijnë rrënjët edhe më shumë e më thellë në vend, në ndërmarrje dhe në degë. Dhe kështu të vazhdojë të rritet.

Për një Unia të fortë ka nevojë edhe në vitet e ardhshme. Sepse në ekonomi edhe më tutje ka shenja të stuhisë. Më 2008 përplasa në botën financiare ka shkaktuar një cunami në përmasa botërore. Që atëherë, ekonomia e profitit është tundur në themelet e saj, edhe Zvicra nuk ka mbetur e paprekur. Franka zvicerane e mbivlerësuar, vala e largimeve nga puna dhe sulmet në arritjet tona sociale, janë pasojat. Edhe një herë të pasurit dhe të pushtetshmit e kanë përfshirë politikën para vetes dhe përpiqen që gjithë barrën dhe shpenzimet t'ua ngarkojnë punëtorë/eve dhe pensionistë/eve. Njerëzit në Evropën Jugore momentalisht janë duke vuajtur jashtëzakonisht shumë nga ky sulm brutal. Kësaj duhet t'i kundërvëhet Unia me sukses. Kongresi në Cyrih ka përcaktuar synimet dhe udhëheqjen, e cila do të mundësojë këtë – dhe me këtë e ka lansuar etapën e ardhshme.

Renzo Ambrosetti, Ko-President i Unia
Andreas Rieger, Ko-President i Unia



Këta caktojnë drejtimin

Në Kongresin e parë në Lugano, delegatët e Unia kanë bërë plane të mëdha. Në Cyrih tani ata do të bëjnë bilancin dhe do të caktojnë drejtimin për periudhën e ardhshme midis kongreseve.

2



Këta kandidojnë

Nëntë personalitete kandidohen për zgjedhjet në Udhëheqjen Ekzekutive të Unia (UE). Për Presidencën është një kandidaturë në tandem.

2-3



Këta e bëjnë Unia

Dhjetëra mijëra anëtarë të angazhuar përbëjnë fytyrën e Unia. Ne do t'ua tregojmë disa pika kulmore nga katërvjeqari i kaluar.

4

UNIA

**Die Gewerkschaft.
Le Syndicat.
Il Sindacato.**

Programi

Enjte 29.11.

Prej orës 13.00h Regjistrimi i delegatëve dhe mysafirëve

14.00h Hapja e Kongresit, përshëndetjet, konstituimi, rendi i ditës, procesverballi, dhe Rregullorja e punës

rreth 15.00h Fjalim Ministri Alain Berset
Raporti i veprimtarisë, një retrospektivë me film të shkurtë

Diskutimi për raportin e veprimtarisë
Zgjedhjet e UE: numri i anëtarëve në UE

Rezoluta e parë
Përshëndetje nga Këshilltari kantonal i ZH, Mario Fehr

Përfundimi me C@ntastorie:
Intermeco për Imigracionin

rreth 18.30h Fund i ditës së parë të Kongresit; më pastaj program i regjioneve

Premtje 30.11.

08.15h Yjet fikse
Strategjia e Unia 2013-2016
Dokumenti i pozicionimit Sigurimi i pleqërisë

ndërmjet Fjalim Solidar/Solifonds dhe Rezoluta për Kinën
Nderim i të vdekurve

11.30h Aksion në Paradeplatz

12.30h Pauza e drekës

13.30h Pikat kyçe 2013-2016 dhe parashtrësata tjera
Zgjedhjet, Presidenca dhe UE

Ratifikimi i nominimeve për KQ
Fjalim Paul Rechsteiner

rreth 18.15h Përfundimi i ditës së dytë të Kongresit

Shtunë 1.12.

08.15h Dokumenti pozicionues Imigrimi
Vazhdim Pikat kyçe 2013-2016 dhe kërkesa të tjera

Fjalim mysafir ndërkombëtar
Lamtumira e anëtarëve të tërhequr të UE

Rezolutat
rreth 12.30h Përfundimi i Kongresit

Kongresi 2012 në Cyrih

Kongresi i Unia përcakton drejtimin

Statuti i Unia thotë shkurtë e qartë: «Kongresi është organi më i lartë i Unia». Prandaj, të 400 delegatët e Kongresit gjatë tri ditëve të Kongresit, prej 29 nëntor deri më 1 dhjetor, do të marrin vendime themelore: ata do të diskutojnë për raportin e veprimtarisë si dhe për bilancin e periudhës së kongresit të fundit, ata do të zgjedhin udhëheqjen dhe do të vendosin për tri dokumente bazë, të cilat definojnë strategjinë e Unia për katër vitet e ardhshme.

Yje fikse për Unia

Ku duam të shkojmë me sindikatën tonë dhe për çka do të angazhohemi bashkërisht? Për këtë pyetje Kongresi i ka katër të ashtuquajtur «Yje fikse», të cilët janë përpunuar dhe diskutuar në një proces diskutimesh të mbështetur gjërë në regjione, në grupet e interesit dhe në sektorë.

Këto janë:

- Punë e mirë për të gjithë: kushte të sigurta dhe të shëndetshme të punës, paga më të mira, jo diskriminim të femrave në paga, jo zbritje të pagave, ndarje e drejtë e punës së paguar dhe të papaguar, mbrojtje më e mirë e vendit të punës.
- Zgjerim i të drejtave sociale dhe mbrojtjes: jo diskriminim, forcim i mekanizmave socialë, zhvillim i përkujdesjes së pleqërisë.
- Shperndarje e drejtë: fitimet nga kapitali dhe trashëgimitë të tatimohen, shanse edukimi për të gjithë, tatime progresive dhe barazi për femrat.
- Një ekonomi për njerëzit: reformim social dhe ekologjik i ekonomisë, frenim i ekonomisë financiare, forcim i shërbimeve publike, sigurim i qirave që mund të paguhen, ekonomi dhe shoqëri demokratike.

Strategjia, pikat kyçe... dhe 200 parashtrësata

Veç kësaj, delegatët do të këshillohen edhe për shtatë «Qëllimet strategjike», të cilat do të përcaktojnë se si do t'i arrijë Unia synimet përmbytësore të Yjeve fikse. Këtu kemi të bëjmë me mundësitë e rritjes së ndikimit për anëtarët aktivë; mobilizimet dhe grevat, zhvillimi i mëtutjeshëm i KKP, zhvillimi i masave anësore, mbrojtja e aritjeve në Ligjin e Punës, shtimi i anëtarësisë, politika aktive shoqërore dhe ekonomike, përmirësimi i gjendjes së migrantëve/eve, angazhimi sindikal ndërkombëtar; funksionimi profesional dhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve.

Në një dokument tjetër me titull «Pikat kyçe» kemi të bëjmë me masat konkrete për katër vitet e ardhshme. Për këto tri dokumente bazë – Yjet fikse, Strategjia dhe Pikat kyçe – janë shtruar rreth 200 parashtrësata nga regjionet, grupet e interesit dhe sektorët.



Përkujdesja e pleqërisë dhe politika e Imigracionit

Delegatët e Kongresit, veç tjerash, do të diskutojnë edhe për dy dokumente pozicionuese. Dokumenti «Zgjerim në vend të shkurtimit të pensioneve të pleqërisë!» kërkon pensione më të mëdha të AHV/AVS, sigurimin e shtyllës së dytë dhe një fleksibilizim të tërheqjes së parakohshme për shkak të pleqërisë në degët e tjera – në mënyrë që njerëzit me të ardhura të ulëta dhe të mesme edhe në pleqëri të jetojnë me dinjitet. Dokumenti «Zvicra – vend i Imigrimit» kërkon një fushatë gjuhësore dhe arsimore për migrante/ët, forcimin e masave mbrojtëse kundër zbritjes së pagave, një politikë aktive të ndërtimit të banesave shoqërore dhe zhvillimin e trafikut publik. Edhe për këto dokumente ka një varg parashtrësash për ndryshime.

Kongresi zgjedh udhëheqjen e re

Premierë në maje të Unia

Zgjedhja e Presidencës, e Udhëheqjes Ekzekutive dhe e Kryesisë Qendrore për katër vitet e ardhshme, është një detyrë e rëndësishme e Kongresit të Unia.

Para zgjedhjeve aktuale, delegatët e Kongresit kanë përcaktuar numrin e anëtarëve të Sekretariatit. Sipas Statutit, Kongresi mund të caktojë numrin në shtatë, tetë apo nëntë anëtarë. Po ashtu, në Statut është ngulitur kuota gjinore – një e treta femra, kjo domethënë gjithësi një numër minimal prej tri femrave.

Për herë të parë kandidon një femër

Së pari do të zgjedhet Presidenca. Vania Alleva dhe Renzo Ambrosetti janë deklaruar për një Ko-Presidencë. Kjo është një premierë: me Alleven për herë të parë kandidon një femër për pozitën më të lartë në Unia. Pastaj delegatët do të zgjedhin udhëheqësit e katër sektorëve. Për këtë, delegatët e kuvendeve të degëve – pjesërisht edhe me fushata zgjedhore – kanë bërë nominimet e tyre. Vania Alleva për sektorin terciar (deri tani), Aldo Ferrari për degën e zanateve (deri tani), Corrado Pardini për industrinë (deri tani) dhe Nico Lutz për ndërtimtarinë (i ri). Po ashtu, në një zgjedhje individuale do të caktohet përgjegjësi për financat. Këtu është nominuar Martin Tanner. Përfundimisht do të zgjidhen edhe anëtarët e tjerë të Udhëheqjes Ekzekutive. Rita Schiavi do të rikandidohet. Corinne Schärer si dhe Pierluigi Fedele janë të nominuarit e ri. Nuk do të

rikandidohen më Ko-Presidenti Andreas Rieger, Hansueli Scheidegger dhe Fabienne Kühn. Pa marrë parasysh si do të përfundojnë zgjedhjet, që tani është e qartë se: Udhëheqja e re ekzekutive do të jetë dukshëm më e re se ajo e deritashmja.

Më shumë anëtarë pa pagesë në KQ

Delegatët e Kongresit do të zgjedhin po ashtu edhe Kryesinë Qendrore. Sipas vendimeve të Kongresit të jashtëzakonshëm në mars 2012, do të zgjedhen edhe anëtarë shtesë pa pagesë.



Vania Alleva dhe Renzo Ambrosetti kandidojnë për Ko-Presidentë.



Vania Alleva, 1969, qytetare e dyfishtë zvicerano-italiane



Renzo Ambrosetti, 1953, dy fëmijë



Pierluigi Fedele, 1973, dy vajza, qytetar i dyfishtë zvicerano-italian

«Unia është një forcë e fortë shoqërore. Së bashku ne do të fitojmë shanset e barabarta dhe barazinë dhe kështu një jetë e punë të dinjitetshme për të gjithë.»

■ **Arsimimi:** Studium an der Universität Rom, Nachdiplomstudium Interkulturelle Kommunikation. Studimet në universitetin e Romës, studimet pasdiplomike komunikimi ndërkulturore.

■ **Profesionet:** Punë të ndryshme, gazetare, mësimdhënëse. Tani 15 vjet në Unia respektivisht në GBI, me detyra të ndryshme udhëheqëse. Prej vitit 2008 udhëheqëse e sektorit terciar dhe anëtare e Udhëheqjes Ekzekutive të Unia si dhe Zëvendës – Kryetare e SGB.

■ **Angazhimet:** Ngritje në profesionet e shërbimeve. Përpunueshmëria midis profesionit dhe familjes. Lufta kundër diskriminimit, kushteve të këqija të punës dhe shkurtimeve të të arriturave sociale.

■ **Unia-Prioritetet:** Ne do të arrijmë një ndarje më të drejtë të pagave dhe të pasurisë, më shumë mbrojtje për punëmarrësit dhe siguri sociale për të gjithë. Ne e forcojmë sindikatën me njerëzit e besueshëm në ndërmarrje, degë dhe në regjione.

«Unia duhet të bëhet edhe më e fortë. Ne do ta arrijmë këtë me afërsi më të madhe me anëtarët, me bisedime të mundimshme për GAV dhe me presion masiv mbi politikën.»

■ **Arsimimi:** Studimet në shkencat juridike.

■ **Profesionet:** Prej vitit 1978 sekretar sindikal i SMUV, prej vitit 1994 anëtar i Udhëheqjes Ekzekutive, prej vitit 2000 Kryetar. Që nga viti 2004 Ko-President i Unia. Më 2007 zgjedhja si Kryetar i Sindikatës Evropiane të Metalistëve. Që nga qershori 2012, nënkryetar i sindikatës më të madhe evropiane IndustriALL (7 milion anëtarë). Ish deputet kantonal dhe komunal i SP në Bellinzona.

■ **Angazhimet:** Ashpërsimi i masave anësore, pagat minimale në të gjitha GAV dhe barazi e pagave për të gjithë. Pikat kyçe: zhvillimi i anëtarësisë, aftësitë mobilizuese dhe prani e madhe në ndërmarrje.

■ **Unia-Prioritetet:** Koncentrim më i madh në detyrat sindikale, integrim më i mirë i njerëzve tanë të besueshëm dhe kuadrore sindikale dhe më pak burokraci.

«Unë e dua një sindikatë të anëtarëve, e cila është e ngulitur në ndërmarrje dhe në regjione.»

■ **Arsimimi:** Farmacist me diplomë federale të aftësimin, teknik i diplomuar për radiologji mjekësore.

■ **Profesionet:** Deputet kantonal dhe komunal i PdA në Delemont/Jura, sekretar respektivisht Kryetar i PdA Jura, i punësuar në spital, anëtar aktiv i VPOD, prej vitit 2008 sekretar regional i Unia Transjurane.

■ **Angazhimet:** Lufta kundër zbritjes së pagave, zhvillimi i masave anësore për lirinë e lëvizjes së personave, pagat minimale, zhvillimi i sindikatës në industrinë e orëve.

■ **Unia-Prioritetet:** Luftën kundër pagave minimale ta fitojmë, shtimi i numrit të anëtarëve, përmirësimi i arsimit të anëtarëve, koordinim më i mirë i prioritetëve nacionale; më shumë energji, që ne sot e përdorim për çështje të brendshme, ta përdorim më mirë për konfrontimet shoqërore.

Këtë e kemi arritur ne

Në Kongresin e parë në Lugano Unia i ka vënë vetes qëllime ambicioze. Çka nga këto kemi arritur ne për katër vitet e kaluara?

Në tetor 2008, delegatët e Unia në Lugano kanë përcaktuar shtatë qëllime strategjike. Forcimi i anëtarëve aktivë, përmirësimi i afësisë sonë mobilizuese dhe për fushata, rritja e anëtarësisë dhe sidomos më shumë anëtare femra, përparime në KKP dhe në zbatimin e tyre, si dhe këshillime dhe përkujdesje kompetente dhe eficiente të anëtarëve të Unia. Kongresi i rregullt në prag, i dyti me radhë, në Cyrih, duhet të bëjë bilancin e të arriturave.

Bazë e fortë për një Unia të fortë

Me projektin «Unia forte» puna e njerëzve të besueshëm dhe puna me ta në Unia ka bërë një kërcim të dukshëm kualitativ. Majat e ndritshme të përkohshme ishin Kongresi i jashtëzakonshëm në Lozanë më 2010, i cili ka miratuar dokumentin e pozicionimit «Të forcohen njerëzit e besueshëm», si dhe të dy evenimentet e organizuara nacionale «Unia forte» në vjeshtë 2010 në Olten dhe në Pranverë 2012 në Bern.

Aftësia për fushata e Unia ka bërë përparime të dukshme në fushën politike. Shembulli më spektakular: Referendumi i sukseshëm kundër uljes së shkallës së konvertimit të parapërkujdesjes profesionale. Në nivelin e ndërmarrjeve dhe në ballafaqimet midis degëve të ndryshme, në një ambient të vështirë ekonomik, ka pasur mobilizime të suksesshme por edhe dështime. Synimin ambicioz për rritje për anëtarësimin në Unia, megjithatë nuk e ka arritur. Pas një faze të stabilizimit po vërehet qartë se ka një trend rritjeje. Rritje të dukshme ka para së gjithash në sektorin terciar. Veçanërisht për t'u gëzuar bën fakti i rritjes së numrit të anëtarëve femra. Caku i vënë, që deri në fund të vitit 2012



Kongresi i Unia më 2010 në Lozanë vendosi për forcimin e njerëzve të besueshëm.

të arrihet një pjesëmarrje e femrave mbi 20%, me 23% ne e kemi tejkaluar. «Fytyra» e Unia bëhet gjithnjë më femërore. Edhe profesionalizimi për përkujdesjen individuale të anëtarëve po tregon efektet.

Kompetenca themelore KKP

Me gjithë situatën e vështirë, Unia ka bërë përparime të rëndësishme në shumë GAV. Para së gjithash, ajo ka arritur që ta zbrapsë sulmin e punëdhënësve dhe të pengojë përqesimet. Sot rreth 1.7 milionë punëmarrës në Zvicër janë nën një GAV – 100000 më shumë se para katër vitesh. Veç kësaj, Unia ka përmirësuar zbatimin e disa GAV të rëndësishme, pikërisht

në ndërtime dhe në degët e zanateve si dhe në gastronomi. Me zbulimin spektakular të rasteve të zbrictjes së pagave, ka arritur të senzibilizojë publikun e gjerë me këtë temë. Unia ka përjetuar vite të bujshme. Me gjithë krizën e tregjeve financiare, rënien ekonomike globale, spekulimin me Frankën, mbylljen e ndërmarrjeve dhe histerinë e kursimeve, ajo është mbajtur mirë dhe ka dhënë një kontribut vendimtar për mbrojtjen dhe për forcimin e arritjeve sociale në Zvicër. Unia si organizatë është stabilizuar dhe ka bërë përparime të rëndësishme. Mirëpo, zhvillimi i mëtutjeshëm i këtyre hapave të mirë do të jetë sfida më e madhe e viteve në vijim.

Vite plotë ngjarje

Me raportin mbi veprimtarinë, Unia ka bërë bilancin gjithpërfshirës të katër viteve të kaluara.



Libri i fortë me 100 faqe përmban mbi 300 fotografi dhe dhjetëra tabela dhe diagrame të angazhimit të Unia në katër vitet e kaluara. Tregon shumëllojshmërinë e anëtarëve dhe të aktiviteteve tona dhe dokumenton, se si Unia dëshmohe si një lëvizje e gjerë shoqërore dhe njëkohësisht si organizatë e udhëhequr në mënyrë profesionale, në ballafaqimet për kushte më të mira të punës dhe përparimin shoqëror. Ofron një thesar me të dhëna dhe shifra për zhvillimin e sektorëve të veçantë dhe degëve të rëndësishme, për punën e 14 regjioneve të Unia, për grupet e interesit dhe për arkën e papunësisë, si dhe për zhvillimin e anëtarësisë.

Raportin mbi veprimtarinë mund të porositet para shtypjes në: Unia Zentralsekretariat, Weltpoststrasse 20, 3000 Bern 15.

Impressum Beilage zu den Gewerkschaftszeitungen work, area, Événement syndical | **Herausgeber** Verlagsgesellschaft work AG, Bern, Chefredaktion: Marie-José Kuhn; Événement syndical SA, Lausanne, Chefredaktion: Sylviane Herranz; Edizioni Sociali SA, Lugano, Chefredaktion: Gianfranco Helbling | **Redaktion** Hans Hartmann, Tom Cassee, Katja Signer | **Druck** Ringier Print, Adligenswil | **Gestaltung** Carole Lonati und Esther Wickli | **Adresse** Unia, Weltpoststrasse 20, Postfach 272, 3000 Bern 15.



Aldo Ferrari, 1962, një vajzë, qytetar i dyfishtë zvicerano-italian

«Unia duhet të bëhet një sindikatë gjithëzvicerane, e cila mbështetet në regjione të forta – një sindikatë e anëtarëve në shërbim të anëtarëve.»

Arsimimi: Elektromekanik, Diplomë federale e aftësisë si ekspert për sigurimet sociale.

Profesionet: Elektromekanik, vozitës në ndërmarrjet publike, që nga viti 1996 sekretar sindikal në GBI, prej vitit 2000 sekretar regjional dhe prej vitit 2010 anëtar i Udhëheqjes Ekzekutive të Unia.

Angazhimet: Parakujdesi i pleqërisë dhe siguria sociale, zgjidhjet për pensionimin e parakohshëm në degët të ndryshme. Ngritja profesionale. Përmirësimi dhe zbatimin i GAV të re. Masat anësore për lirinë e lëvizjes së personave dhe lufta kundër zbrictjes së pagave. Sigurimi i obligueshëm shëndetësor ditor.

Unia-Prioritetet: Rritja e anëtarësisë, për t'u lidhur më mirë. Ngritja e aftësisë mobilizuese. Forcimi i rolit të njerëzve të besueshëm.



Nico Lutz, 1970, tre fëmijë

«Vetëm me një Unia të fortë dhe luftarake ne mund të pengojmë që të pasurit të pasurohen edhe më shumë dhe punëtorë/et të vuajnë kollin për këtë.»

Arsimimi: Studimet në shkencat politike dhe planifikimi i trafikut.

Profesionet: Gati para 20 vitesh kam filluar të punoj për sindikatat: në fillim në regjionin te GBI, pastaj te VPOD, prej vitit 2004 e bashkudhëheq repartin e komunikimit dhe të fushatave për Unia në Zvicër.

Angazhimet: Aksionet në ndërmarrje, fushatat për kontrata, grevat, demonstratat, fushatat e votimeve, tërheqja e anëtarëve të rinj, kujdesi ndaj anëtarëve. Veç kësaj, lëvizjet paqësore dhe kundër atomit. Çfarë më nxit mua: ka nevojë për më shumë drejtësi sociale në këtë vend dhe në botë.

Unia-Prioritetet: Kohët janë gjithnjë e më të vështira: ne duhet të fitojmë më shumë luftëra, në të gjitha degët tona. Kjo mund të arrihet vetëm nëse ne ngulitemi edhe më shumë në ndërmarrje. Prandaj forcimi i njerëzve të besueshëm me Unia Forte është i rëndësishëm



Corrado Pardini, 1965, dy fëmijë, qytetar i dyfishtë zvicerano-italian

Unia është e fortë dhe e besueshme, nëse anëtarët tanë dhe njerëzit e besueshëm bashkëvendosin në çështjet e rëndësishme dhe strukturat tona demokratike forcohen.

Arsimimi: Zanati si makinist, gjimnazi ekonomik, Dipomë në studimet për menaxhimin e shoqatave.

Profesionet: Sekretar sindikal në GBH/GBI/Unia prej vitit 1987. Prej vitit 2008 anëtar i Udhëheqjes Ekzekutive të Unia-Udhëheqja Ekzekutive dhe udhëheqës i sektorit të industrisë. Në periudhën 2002-2011. Këshilltar i lartë në Kanton Bern, prej vitit 2011 deputet në parlamentin nacional.

Angazhimet: Për një vendpunishte të fortë falë arsimimit dhe ngritjes dhe një politikë industriale aktive. Reforma ekologjike. GAV gjithpërfshirëse dhe kontrolle sistematike të tregut të punës. Siguri sociale. Barazi të pagave dhe të shanseve për të të gjithë. Respekt dhe punë më të mirë për të gjithë të punësuarit.

Unia-Prioritetet: Falë bazës së gjerë Unia është një sindikatë e fuqishme. Ajo bisedon me ndërmarrjet si e barabartë.



Corinne Schärer, 1964, tre fëmijë

Hajnat, zbrictja e pagave, pagat e ulëta të femrave – botë së prapthi. Me një Unia të fortë, ne së bashku do ta kthejmë së mbari.

Arsimimi: Studimet në histori dhe anglisht.

Profesionet: Mësimdhënëse në shkollë të mesme, sekretare e sektionit të VPOD në Cyrih, sekretare e përgjithshme e unia të vogël, sekretare regjionale e VPOD në Bern, prej vitit 2009 udhëheqja e departamentit për politikë të kontratave dhe të grupeve të interesit në Unia dhe sekretare femër, deputete kantonale deri në vitin 2012.

Angazhimet: Barazia në përgjithësi dhe barazia e pagave, pajtueshmëria midis profesionit dhe familjes, paga (minimale) korrekte, arsimimi dhe ngritja profesionale, lufta kundër diskriminimit dhe punës së keqe, AHV, politika e migracionit dhe e integritimit, perspektiva për të ardhmen e rinisë.

Unia-Prioritetet: Me «Unia Forte» dhe njerëzit e besueshëm aktivë në ndërmarrje, të bëhemi edhe më të fortë. Zhvillimi i profesionit e shërbimeve, për femrat të bëhen edhe më tërheqëse.



Rita Schiavi, 1955, dy fëmijë, qytetare e dyfishtë zvicerano-italiane

«Unë jam e bindur se një botë tjetër – jo-kapitaliste – është e mundur.»

Arsimimi: Studimet për sociologjinë dhe edukimin shtesë si edukatore e të rriturve.

Profesionet: Mësimdhënëse, udhëheqëse e kurseve dhe sekretare në sindikatën GTCP. Prej vitit 2000 anëtare e kryesisë të GBI respektivisht Unia. Në ndërkohë edhe sekretare regjionale për Zvicrën Veriore.

Angazhimet: Që kur jam aktive në politikë – që mbi 35 vjet – angazhohem për të drejtat e migrantëve/eve. Politika sociale, sidomos përkujdesja për të moshuarit, është po ashtu një temë e rëndësishme. Unë dua të forcoj AHV dhe të pengoj humbjet e tjera si dhe vjedhjen e shtyllës së 2-të.

Unia-Prioritetet: Rritja e aftësisë mobilizuese dhe forcimi i grupeve aktive të anëtarëve. Të sigurohet kompetenca udhëheqëse e kuadrove të Unia, më shumë femra në pozita udhëheqëse.



Martin Tanner, 1967

«Po të tërheqim të gjithë në të njëjtin vend, ne mund t'i arrijmë qëllimet dhe pritjet tona të larta.»

Arsimimi: Studimet në Shkollën e Lartë Profesionale për Ekonomi (HFW) në Bern.

Profesionet: Zanati dhe puna në Schweizerische Kreditanstalt dhe në Schweizerische Bankverein. Udhëheqës i repartit për administrimin e pronës në administratën e pronës në Unia ZIVAG. Prej vitit 2000 udhëheqës i repartit të financave (Kontabiliteti, Controlling, administrim i pasurisë) në sindikatën SMUV respektivisht Unia.

Angazhimet: Zhvillimi i Kontratave të Përgjithshme të Punës (GAV). Pagat minimale për sigurimin e ekzistencës. Pengimi i zbrictjes së pagave. Vende të mjaftueshme dhe të mira për praktikën për nxënësit. Pensionim fleksibil. Barazia e femrave si dhe për të punësuarit e plotë dhe të pjesërishtëm.

Unia-Prioritetet: Zhvillimi i rrjetit të njerëzve të besueshëm dhe i numrit të anëtarëve. Financat e shëndosha të sindikatës, për të investuar në projektet e orientuara në të ardhmen.

Ne jemi Unia...

Dhjetëra demonstrata me zë të lartë, protesta dhe greva, qindra aksione kreative, dhjetëra mijëra anëtarë aktivë: ata e kanë bërë Unia një lëvizje të fortë shoqërore në katër vitet e shkuara. Kjo faqe tregon disa pika kulmore nga kjo kohë e gjallë.

2 maj 2009, njëzet të punësuar në shitoren e karburanteve – Spar afër Tunit, hynë në grevë për shkak të punës së detyrueshme jashtë orarit dhe orarit të zgjatuar të hapjes së shitores, me sukses: zgjidhja e arritur me bisedime sjell paga më të larta, vende të reja pune dhe mbron të punësuarit nga puna e tepërt jashtë orarit.



18 shtator 2010, në Olten takohen 400 sindikalistë/e aktivë të Unia nga e tërë Zvicra dhe lansojnë projektin «Unia Forte», për forcimin e njerëzve të besueshëm.



19 shtator 2009, 30000 njerëz, në mesin e tyre sidomos shumë anëtarë të Unia, demonstronjë në Bern kundër vjedhjes së pensione dhe shkurtimeve sociale. Ata kërkojnë nga Bundesrati dhe nga shumica parlamentare, që përfundimisht të luftojnë krizën, në vend që ta zvarrisin atë.



25 janar 2011, me aksione protestuese në tërë Zvicrën, Unia lanson iniciativën për pagat minimale.



15 dhjetor 2009, në Bern, Tun dhe Burgdorf protestojnë aktivistët dhe aktivistet e Unia me pipëza dhe pano kundër vjedhjes së pensione në shtyllën e dytë. Më 7 mars 2010, Unia së bashku me sindikatat e tjera e fitojnë më shumë se qartë Referendumin.



8 shkurt 2011, me një grevë njëditore të prodhuesit të transformatorëve Trasfor në Monteggio, të punësuarit e pengojnë zgjatjen e orarit të punës pa kompensim page.



14 qershor 2011, në ditën nacionale të aksionit të grave, organizohen qindra pauza të zgjatura, marshe për barazi dhe aksione të bujshme. Kërkesa: përfundimisht duhet të ecet përpara me barazinë.

30 mars 2010, Unia kontribuon në mënyrë vendimtare që Referendumi kundër shkurtimeve të Sigurimit të Papunësisë (AVIG) të kalojë.



24 shtator 2011, 12000 punëtorë ndërtimtarie nga e tërë Zvicra demonstronjë në Bern për një Kontratë të Përgjithshme Kombëtare.



12 tetor 2011, Unia dhe emisioni televiziv «Kassensturz» raportojnë për kushtet skandaloze të punës në shtëpinë e modës Zebra. Presioni ka efekt: Shumat që mungojnë në arka të shitjes më nuk u hiqen nga pagat të punësuarve, dhe kontrolli poshtëruet i çantave të dorës hiqet. Në foto: bashkëpunëtorët e Zebra – Vanessa Romang dhe Jennifer Riesen.



17 janar 2012, një grevë mbreslënëse dhe përkrahja e madhe e popullatës e detyrojnë gjigantit farmaceutik Novartis, të heqë dorë nga mbyllja e repartit të vet në Nyon.



20 shkurt 2012, delegatët e Unia të gastronomisë kërkojnë nga Banka Kombëtare Zvicrane (SNB), që të ngre lart kufirin e poshtëm të këmbimit në 1.40 Franka për një Euro. Zëvendës-presidenti i SNB Jordan, pas përfundimit të protestës, e pranon një kërkesë me shkrim.



7 qershor 2012, në kantierin e ndërtimtarisë së kampusit të Novartis në Bazel, bëjnë grevë punëtorët e ndërtimtarisë së nënkontraktorit të e-Therm AG të ndërmarrjes ndërtimore Frutiger AG. Ata e imponojnë me këtë rast respektimin e GAV. Në foto: bashkëpunëtorët e e-Therm Bernd Stützer, Bernd Momm dhe Andreas Meyer.



12 qershor 2012, të punësuarit në ndërmarrjen farmaceutike në Gjenevë Merck Serono hyjnë në një grevë paralajmëruese. Ata kërkojnë që propozimet e të punësuarve për ruajtjen e vendeve të punës përfundimisht të trajtohen seriozisht.



22 shtator 2012, mbi 5000 njerëz kërkojnë në demonstratën më të madhe të industrisë prej disa dhjetëra vitesh, përmirësime në MEM-GAV dhe një politikë industriale aktive për reformën eko-sociale të ekonomisë.

